VENDIM
Nr. 222, datë 10.8.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "KRONOS KONSTRUKSION" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa "a", 41, pika 1, germa "a" dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2233/1 prot., datë 5.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Kronos Konstruksion' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

-Shoqëria "Kronos Konstruksion" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2233 prot., datë 27.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

-Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

-Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a", "b", "c" dhe "d".

-Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe "c".

-Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "b", "d" dhe "f".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria "Kronos Konstruksion" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në datën 15.6.2026, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë, nga shoqëria 'Kronos Konstruksion' sh.p.k.";

- Ka marrë miratimin paraprak për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) nr. 1453/2 prot., datë 18.3.2025;

-Është pajisur me VNM paraprake nr. AN150420250019, datë 5.6.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit "Park fotovoltaik 50 mw", dhe VNM paraprake nr. AN150420250015, datë 5.6.2025 për zhvillimin e projektit "Parku fotovoltaik dhe rrjet kabllor ajror", lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin, si vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare për realizimin e investimit, sipas modalitetit të parashikuar në planin e biznesit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1: Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa "a": depozitojë garanci për panelet që do të përdorë, në rast se ka, në mënyrë që të rakordohet dhe vlefshmëria e licencës, si dhe të përcaktojë një datë konkrete për fillimin e operimit;

- germa "c": të sqarojë/saktësojë kapacitetin e instaluar të centralit, i cili do të pasqyrohet dhe në miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjes respektive, që duhet të depozitohet në ERE;

- germa "e": të japë informacion në rast se kanë filluar punimet për ndërtimin e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1.Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Kronos Konstruksion" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë.

2.Shoqëria "Kronos Konstruksion" sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet përkatëse të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Kronos Konstruksion" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti